



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

Nr. ____ Prot

Datë 23.09.2009

Vendim
Nr.124 datë 23.09. 2009

“Për disa rekomandime mbi dokumentin e AKEP “Analiza e Tregut Celular: Tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë i shërbimeve publike celulare”

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
Servete	GRUDA	Anëtare
Koço	BROKA	Anëtar
Rezana	KONOMI	Antare

Në mbledhjen e tij të datës 23/09 / 2009, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e dokumentit të AKEP ***“Analiza e Tregut Celular: Tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë i shërbimeve publike celulare” dhe dhënia e rekomandimeve***

Baza ligjore:

- Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, germa f dhe neni 70, pika 2.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të dokumentit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare(AKEP) ***“Analiza e Tregut Celular: Tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë i shërbimeve publike celulare”*** si dhe relacionit të Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (këtu e si vijon AKEP), me anë të shkresës Nr. 312, datë 29.07.2009, kërkon mendimin e Autoritetit të Konkurrencës mbi vendimit Nr. 748 të AKEP, “Analizë e Tregut Celular: Tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë i shërbimeve publike celulare: Konsultim Publik”, veçanërisht për problemet që lidhen me tregun e pakicës.

Nga analiza e dokumentit rezulton se:

- 1) Ndryshimi kryesor në Tregun e Telefonisë së Lëvizshme për periudhën objekt të analizës së AKEP është hyrja ‘de facto’ në treg e operatorit të tretë, licensë e zotëruar nga Albtelcom Sh.A si pjesë e paketës së privatizimit të kësaj kompanie.
- 2) AKEP i ka dhënë operatorit të katërt celular GSM, Mobile 4 AI, të drejtën e përdorimit për 15 vjet, në brezin e frekuencave E-GSM dhe GSM 1800.
- 3) Në tregun celular ekzistojnë përsëri pengesa për hyrjen në treg të operatorëve të rrjeteve megjithëse nuk ka pengesa ligjore për ofruesit e pavarur të shërbimeve celulare me pakicë apo MVNO, aktualisht **nuk ka asnjë hyrje në treg.**
- 4) AKEP vlerëson se Metodologjitë e Rregullimit të Tarifave të Operatorëve me Fuqi të Ndjeshme në Treg (OFNT), të miratuara vitin e kaluar janë zbatuar duke filluar nga data 8 shtator 2008, nga Vodafone Albania, dhe 15 Shtator 2008 nga AMC dhe Albtelcom.
- 5) Objekti i rregullimit të tarifave të telefonisë celulare janë tarifat e thirrjeve telefonike kombëtare dhe ndërkombëtare **vetëm** për përdoruesit me parapagim.
- 6) Ulja e tarifave pritet të vazhdojë pasi AKEP ka filluar një projekt të vlerësimit të kostove BULRAIC të operatorëve celulare, nëpërmjet një konsulentit ndërkombëtar. AKEP gjykon se rregullimi i tarifave të terminimit të operatorëve celulare, duhet të kryhet për periudhën 1.09.2009 - 31.08.2010

AKEP arrin në disa konkluzione që sa i përket konkurrencës do të veçojmë:

I. Mundësia e koordinimit të sjelljes së Vodafone-AMC

1. Tregu mbetet shumë i përqëndruar megjithë hyrjen e konkurrentit të tretë dhe pjesët e ngjashme të tregut të AMC dhe Vodafone Albania në vite janë tregues të simetrisë midis operatoreve dhe stimujve për të koordinuar veprimet.
2. Hyrja në treg e “Eagle Mobile” në Mars 2008, duket se nuk ka ndikuar në të ardhurat dhe fitimet e AMC dhe Vodafone, të cilët në vitin 2008 kanë fitime neto në nivele shumë më të larta se në vitet e mëparshëm dhe nivele pothuajse të njëjta me njeri tjetrin.
3. Për vitet 2007-2008, rezulton se të ardhurat totale të operatorëve celulare janë rritur në nivele të krahasueshëm me vitet e mëparshme, ndërsa fitimi neto i AMC dhe Vodafone Albania në vitin 2008 është rritur ndjeshëm krahasuar me vitin 2007: 77% për Vodafone dhe 54% për AMC.

4. Si përfundim, AKEP konkludon se “normat e larta dhe të qëndrueshme të fitimit të AMC dhe Vodafone Albania, janë tregues i konkurrencës së ulët dhe stimuj për koordinim midis këtyre dy kompanive”.

II. Marrja parasysh e rekomandimeve të Komisionit të Konkurrencës

Në analizën e bërë nga AKEP thuhet se gjatë periudhës 2007- 2009 janë marrë në konsideratë të gjitha rekomandimet e dhëna nga AK me anë të vendimit Nr. 61, datë 21.11.2007 ‘Për disa rekomandime në tregun e telefonisë së lëvizshme’. AKEP shprehet se janë implementuar të gjitha rekomandimet e AK në lidhje me së fundmi liberalizimin e tregut, aplikimin e metodologjisë së rregullimit të tarifave dhe përshtatje e Ligjit Nr. 8681 me direktivat e BE, me përjashtim të portabilitetit të numrave. Edhe për portabilitetin e numrave AKEP ka publikuar së fundmi një dokument për këshillim publik.

III. Në analizë, AKEP kërkon mendimin e AK në lidhje me pamjaftueshmërinë e Ligjit Nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” për të adresuar në mënyrë të përshtatshme dështimet e tregut të marra në shqyrtim.

Referuar Ligjit 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës ndërhyr kryesisht ex-post. Por vetë ky Ligj i nje Autoritetit të Konkurrencës edhe ndërhyrjen ex-ante, për të cilat shprehet me rekomandimet përkatëse.

Ligji “Për komunikimet elektronike dhe postare në RSH” ia ka dhënë të gjitha atributet entit rregullator që në analizat ex- ante të dështimeve të tregut të marrë të gjitha masat përkatëse për vendosjen e konkurrencës, duke bashkëpunuar dhe me Autoritetin e Konkurrencës. Pra, nuk mund të pretendohet se Ligji “Për mbrojtjen e konkurrencës”, është i pamjaftueshëm për të adresuar dështimet e marrë të tregut në shqyrtim.

Autoriteti i Konkurrencës vlerëson punën e Rregullatorit mbi analizën e tregut, konkluzionet e draftuara dhe propozimet për ndërhyrje të mëtejshme në rregullimin administrativ të tregut të komunikimeve elektronike të paraqitura në dokumentin “Mbi analizën e Tregut Celular: Tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë i shërbimeve publike celulare”,.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa f dhe nenin 70, pika 2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

1. Ti rekomandojë AKEP:

I. Aplikimin metodologjisë së rregullimit të tarifave jo vetëm për shërbimin me parapagesë por edhe për: shërbimin me kontrate; mesazhet elektronike (sms) dhe shërbime të tjera.

II. Aplikimin e “**Metodologjisë së Rregullimit të Tarifave të Terminimit**” derisa tarifat e telefonisë celulare të jenë të krahasueshme me mesataren e tarifave që aplikohen në vendet e Bashkimit European.

III. Dhënien e licencës së re, në Tregun e Telefonisë së Lëvizshme, ta shoqërojë me marrjen e të gjitha masat e nevojshme **për ta bërë sa më shpejt efektiv operatorin e katërt** me synim rritjen e konkurrencës në treg.

IV. Lidhur me shqetësimin e AKEP se ka shenja të mungesës së konkurrencës në tregun e telefonisë celulare, Autoriteti i Konkurrencës kërkon që me miratimin e raportit përfundimtar nga ana e Këshillit Drejtues të AKEP që të gjithë elementët, provat dhe faktet që disponon Rregullatori, në mbështetje të nenit 61, pika 2 të ligjit “Për komunikimet elektronike”, t’ia përcjellë Autoritetit të Konkurrencës për monitorimin dhe hetimin në tregjet përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCES

Servete GRUDA
(_____)
Antare

Koço BROKA
(_____)
Anëtar

Rezana KONOMI
(_____)
Anëtare

Lindita MILO (LATI)

KRYETARE